

ALMA POGONI

UDHËZUESET NË GJUHËN SHQIPE
DIRECTIVES IN ALBANIAN LANGUAGE

1. Hyrje

Studimi i përket lëmit të studimit të pragmatikës dhe më ngushtësisht të teorisë kryesore që është zhvilluar në këtë drejtim gjuhësor, teorisë së akteve të të folurit¹. Teoria e akteve të të folurit njihet sot si një nga teoritë më të reja dhe gjithashtu edhe më të diskutuara në fushë të studimeve gjuhësore. Sipas kësaj teorie, njësia e bashkëveprimit apo e komunikimit gjuhësor nuk është, sikurse është pretenduar, fjala apo fjalia, por realizimi i fjalës apo fjalisë në performimin e një *akti të të folurit*² ose siç njihet ndryshe me termin *akt ilokutiv*³. Pra, realizimi i një fjalie në kushte të caktuara përbën një akt të të folurit dhe akti i të folurit është njësia bazë ose minimale e komunikimit gjuhësor.

Qysh nga lindja e këtij debati, ato që njihen si *teoritë tradicionale*, teoria e Ostinit (J. L. Austin) dhe e Sërilit (J. R. Searle), por edhe teori të tjera që pasojnë dhe ndikohen nga këto (sidomos nga Sërli) rreken të përcaktojnë kritere të mjaftueshme⁴ mbi bazën e të cilave të mbështesin klasifikimin e akteve të të folurit. Sërli pretendon se përcaktimi i një strukture të plotë të kushteve të nevojshme dhe të mjaftueshme për përmbushjen apo performimin e suksesshëm të aktit të të folurit mund të jetë baza e ndërtimit të një strukture rregullash për përdorimin e mjeteve treguese të forcës ilokutive⁵. Në sintaksën e një fjalie mjetet treguese të forcës ilokutive përfshijnë së paku, rendin e fjalëve, intonacionin (shoqëruar edhe me pikësimin), mënyrën e foljeve dhe formën e performatives bashkë me foljet performative⁶. Gjuhë të ndryshme paraqesin ngjashmëri të dukshme në këtë drejtim, por nga ana tjetër edhe dallime, të cilat kushtëzohen nga veçoritë strukturore dhe funksionale që burojnë nga vetë natyra e gjuhëve.

Punimi synon të nxjerrë në pah të gjitha mjetet ilokutive që shërbejnë për të bërë dallimin e njërës prej klasave më të gjera dhe më të pasura në aspektin

¹ Në anglisht, *Speech Act Theory: SAT*.

² Në anglisht, *speech act*.

³ Në anglisht, *illocutionary act*.

⁴ Në anglisht, *necessary conditions*.

⁵ Në anglisht, *illocutionary force indicating devices: IFID*.

⁶ J. R. Searle, *Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*, Cambridge: Cambridge University Press, 1969, f. 30.

pragmatik për gjuhën shqipe, klasës së udhëzueseve⁷. Studiuesit e teorisë së akteve të të folurit e njohin ekzistencën e klasës së udhëzueseve dhe në krahasim me klasat e tjera, qëndrimet ndaj kësaj klase janë shumë të ngjashme dhe shfaqin vetëm pak dallime. Këto ngjashmëri dhe dallime do të jenë objekti i një vështrimi të shpejtë krahasues mbi kufijtë e udhëzueses në pjesën e parë të punimit.

2. Disa përcaktime për klasën e udhëzueseve

2.1. Udhëzueset e Ostinit si grup brenda klasës së ushtrueseve⁸

Aktet udhëzuese Ostini⁹ i ka trajtuar brenda grupit të ushtrueseve. Aktet ushtruese janë ushtrimi i forcës, i të drejtave ose i ndikimit të folësit mbi dëgjuesin (dëgjuesit). Një ushtruese është akti i marrjes së një vendimi pro apo kundër rrjedhës së veprimit; një vendim i marrë nga ana e folësit që diçka duhet të bëhet kështu dhe jo një vlerësim i tij.

Ostini përcakton disa nga grupet më tipike të konteksteve ku mund të përdoren aktet ushtruese dhe në këtë mënyrë bën disa nëndarje brenda kësaj klase:

- Akte të përbushjes së shërbimeve, të pranimit, të dorëheqjes, të shkarkimit, të aplikimit, vënia e kandidaturës;
- Akte të këshillimit, të paralajmërimit, të petitionit;
- Akte të urdhrit, të vendimit, të anulimit;
- Akte të administrimit të mbledhjeve dhe aktiviteteve;
- Akte të përcaktimit të rregullave, dhënia e një deklarate, ngritja e një padie etj.

Pra, në këtë ndarje ai i veçon deri diku aktet udhëzuese dhe i trajton përgjithësisht në dy grupe, në grupin e dytë dhe të tret.

Në vazhdim, Ostini bën një përmbledhje të të gjitha foljeve¹⁰, performimi i të cilave në një akt të të folurit do të përbënte një akt ushtrues; folje të tilla si: *adreso, anulohet, bëj të ditur, caktoj, dedikoj, deklaroj të mbyllur (të hapur) dëshiroj, dirigjoj, dorëzoj, drejtoj, dua, dhuroj, emëroj, fal, gjobit, hap, heq dorë, informoj, jap dorëheqjen, kërkoj, këshilloj, komandoj, kushtoj, lë, lë në kujdes, lë trashëgim, liroj, lutem, mbaj anën e dikujt, mbroj, miratoj, ngulmoj, nxit, njoftoj, paguaj, paralajmëroj, përgjërohëm, përjashtoj, plotësoj, porosis, pretendoj, prezantoj, propozoj, quaj, rekomandoj, rekrutoj, sekuestroj, stimuloj, shfuqizoj, shkarkoj, shpall, shtyj, urdhëroj, vendos, vë veto, votoj, zbuloj, zgjedh etj.*

⁷ Në anglisht, *directives*.

⁸ Në anglisht, *exercitives*.

⁹ John L. Austin, *How to do things with words*. Oxford: Clarendon Press. 1962, f. 150-163.

¹⁰ Nuk është parë e mundur përshtatja në kuptim nga anglishtja në shqip e të gjitha foljeve të dhëna nga Ostini, ndaj janë dhënë vetëm një pjesë e tyre duke u veçuar si më tipike.

Folje si, *adreso*, *caktoj*, *drejtoj*, *dua*, *dhuroj*, *kërkoj*, *këshilloj*, *komandoj*, *lë* (në kujdes, në trashëgim), *liroj*, *lutem*, *ngulmoj*, *nxit*, *paralajmëroj*, *përgjërohem*, *porosis*, *pretendoj*, *propozoj*, *rekomandoj*, *stimuloj*, *shtyj*, *urdhëroj* etj., të përmendura nga Ostini janë folje të mirëfillta udhëzuese dhe klasifikohen si të tilla në të gjitha klasifikimet. Shembujt e foljeve nga anglishtja shpesh nuk kanë të njëjtin funksion pragmatik që kanë gjegjëset e tyre në shqip, ndaj edhe bashkëpërkimet shfaqen disi më të largëta nga njëra gjuhë në tjetrën. Në të vërtetë, në krahasimin midis klasifikimit të Ostinit dhe klasifikimeve të studiuesve të tjerë (brenda anglishtes) edhe për këtë klasë vërehen më tepër ngjashmëri sesa dallime.

2.2. Udhëzueset e Sërli si klasë më vete

Sërli i ka pagëzuar me emrin udhëzuese¹¹. Brenda klasës së udhëzueseve ai përfshin një mori aktesh, si kërkesat, urdhrat, komandat, lutjet, përgjërimit, lejimet, ftesat, këshillat, madje edhe aktet e të guxuarit, të kundërshtuarit, të sfiduarit, të dyshuarit etj.

Qëllimi ilokutiv¹² i akteve udhëzuese lidhet me përpjekjen e folësit për ta udhëzuar dëgjuesin që ai të bëjë (ose të mos bëjë) diçka. Ato mund të jenë udhëzime “të përmbajtura” në trajtën e ftesës, sugjerimit etj., por edhe “të forta” në formën e urdhrit, komandës, këmbënguljes etj. Drejtimi i përshtatjes¹³ është që bota t’i përshtatet fjalës, ndërsa gjendja e shprehur psikologjike¹⁴ është ajo e *dëshirës* (*urimit*, *nevojës*).

Për të kuptuar më mirë natyrën e akteve të të folurit Sërli¹⁵ zhvillon më tej konceptin e kushteve të përmbushjes së aktit¹⁶ duke i dalluar këto si:

- kushte thelbësore, të cilat qartësojnë se çfarë lloj akti duhet të kemi.
- kushte për përmbajtjen propozicionale, të cilat përcaktojnë natyrën e kuptimit të thënies.
- kushte të sinjeritetit janë kushte që lidhen gjithashtu me qëllimet dhe ndjenjat e folësit, por edhe të dëgjuesit.
- kushte parapërgatitore, pra, parakushtet e performimit të aktit, të cilat kanë lidhje si me qëllimet e folësit (para dhe pas aktit të të folurit), besimin

¹¹ J. R. Searle, *Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*, Cambridge: Cambridge University Press, 1969, f. 63-64.

¹² Në anglisht, *illocutionary point*; është një nga kriteret bazë të klasifikimit të Sërli (Searle, 1979:1-8).

¹³ Në anglisht, *direction of fit*; një tjetër kriter.

¹⁴ Në anglisht, *psychological state*; një tjetër kriter.

¹⁵ J. R. Searle, *Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*, Cambridge: Cambridge University Press, 1969, f. 53-58. Por edhe Searle J., *Expression and meaning: Studies in the theory of speech acts*. Cambridge, England: Cambridge University, 1979.

¹⁶ Kushtet e përmbushjes (ose realizimit) të aktit është termi i përshtatur për termin në anglisht, *felicity conditions*.

dhe qëndrimin ndaj asaj që shpreh, ashtu edhe me fakte që i përkasin situatës së ligjërit.

Nëse kushtet e përmbushjes zbatohen konkretisht në rastin e një paralajmërimi (që është një akt udhëzues) si p.sh., *“Të paralajmëroj të mos bësh ...”* analiza e këtij akti do të përmbante në mënyrë të përmbledhur:

- kushte të përmbajtjes propozicionale: a) fakti i shprehur nga folësi F duhet të jetë paralajmërimi për moskryerjen e një veprimi që mendohej do të kryhej (nuk do të kryhej) në të ardhmen nga dëgjuesi D; b) folja e pjesës kryesore të thënies duhet të jetë në kohën e tashme, në vetën e parë, pasi nëse folja do të jetë p.sh., në një nga kohët e së shkuarës apo të së ardhmes, *“Të paralajmërova...”*, *“Të kisha paralajmëruar...”* *“Do të të paralajmëroja...”*, *“Do të të kisha paralajmëruar...”*, do të kishim një pohim dhe jo një paralajmërim;

- kushte parapërgatitore: a) folësi F është i bindur që moskryerja në të ardhmen e veprimit të paralajmëruar do të jetë në interes të dëgjuesit D; b) folësi F beson se dëgjuesi D nuk është në dijeni që moskryerja e veprimit të mësipërm do të ishte në interes të tij.

- kusht i singëritetit: besimi i vërtetë (i singërtë) i folësit F që moskryerja e veprimit do të ishte në interes të dëgjuesit D;

- duke marrë parasysh tri grupet e para të kushteve të përmbushjes, kushti thelbësor ka të bëjë me faktin se kjo thënie duhet të merret (të kuptohet) si një paralajmërim i folësit F për moskryerjen e një akti A nga ana e dëgjuesit D. Nëse kjo thënie merret p.sh., si kërcënim, atëherë akti i paralajmërimit mbetet i papërmbushur.

2.3. Bahu dhe Harnishi: qëndrim kritik ndaj Ostinit dhe Sërlit

Punimi i Bahut (Kent Bach) dhe Harnishit (Robert Harnish), *“Komunikimi gjuhësor dhe aktet e të folurit”*¹⁷ i kushtohet përshkrimit dhe klasifikimit të forcave ilokutive si dhe natyrës së akteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të të folurit.

Siç është paraqitur më lart, sipas Sërlit, natyra e akteve ilokutive është plotësisht konvencionale, ndaj dhe analiza e tyre bëhet duke ndërtuar një set rregullash të cilat përcaktojnë përdorimin konvencional të mjeteve që tregojnë llojin e aktit të performuar. Ky konceptim, sipas studiuesve të teorisë së akteve të të folurit përbën një pengesë të pakapërcyeshme, kur vjen puna te analiza e akteve të tërthorta¹⁸, duke e detyruar Sërlin të vërë përkrah analizës

¹⁷ Kent Bach and Robert M. Harnish, *Linguistic Communication and Speech Acts*, Cambridge, Mass.: MIT Press, 1979.

¹⁸ Analiza kufizohet vetëm te aktet direkte të të folurit, pasi aktet e tërthorta të çdo lloji mund të performohen përmes shqiptimit të çdo lloji fjalie në çfarëdo mënyre të foljes. Aktet e tërthorta të të folurit përkufizohen si thënie, me të cilat një akt ilokutiv, të cilën Sërlit [Searle, 1979:31] e quan *akt parësor (primary illocution)*, p.sh. kërkesa e folësit për t'ia

konvencionale edhe një shpjegim në lidhje me rolin që luan nxjerrja e konkluzioneve¹⁹ në kuptimin e një thënieje si një lloj i caktuar i akteve ilokutive.

Bahu dhe Harnishi besojnë se edhe interpretimi i akteve të drejtpërdrejta bazohet në fund të fundit në procesin e nxjerrjes së konkluzioneve. Të dyja llojet e akteve, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta arrijnë të kuptohen (interpretohen) nga dëgjuesi pa ndërmjetësinë e ndonjë konvencioni tjetër përveç konvencionit gjuhësor që përfshin njohjen dhe përdorimin e një gjuhe të caktuar. Sipas Bahut dhe Harnishit, llojet e ndryshme të akteve ilokutive përcaktohen nga llojet e qëllimeve ilokutive dhe qëllimi ilokutiv përmbushet me njohjen (bërjen të ditur) e sjelljes së shprehur (të folësit) nga ana e dëgjuesit. Prandaj, mund të thuhet se llojet e ndryshme të qëllimeve ilokutive përkrijnë me llojet e ndryshme të sjelljeve (qëndrimeve) të shprehura nga folësi²⁰.

Lidhur me këtë, ata e konsiderojnë aktin e të folurit si një dukuri jokonvencionale duke dalë në kundërshtim me konvencionalitetin e Ostinit²¹ dhe me rregullat themelore²² të Sërlit²³.

Sipas këtij qëndrimi, Bahu dhe Harnishi grupojnë llojet e akteve ilokutive sipas llojeve të sjelljeve të shprehura gjuhësisht duke njohur katër kategori kryesore, çdonjëra prej të cilave ndahet në grupe më të vogla²⁴.

Sipas tyre, udhëzueset janë shprehje të qëndrimit të folësit kundrejt një veprimi të ardhshëm të dëgjuesit, si dhe shprehje të qëllimit të tij që me anë të aktit ilokutiv të shqiptuar të ndikojë në veprimin e ardhshëm të dëgjuesit. Brenda kësaj klase Bahu dhe Harnishi grupojnë kërkesat (requestives), pyetjet (questions requirements), ndalueset (prohibitive), lejueset (permissives), këshillueset (advisories)²⁵.

Në dallim nga Sërlit, ata klasifikojnë si akte njohëse²⁶ grupin e akteve urdhëruese (urdhrrat) dhe si akte konstatuese²⁷ grupin e akteve sugjeruese (sugjerimet).

kaluar kripën realizohet nëpërmjet performimit të një akti tjetër ilokutiv, të quajtur *akt dytësor i fjalëpërfjalshëm* (secondary illocution), të tillë si p.sh., *A mund ta arrish kripën?*.

¹⁹ Në anglisht, *inference*.

²⁰ Po aty, f. 39.

²¹ John L. Austin, *How to do things with words*. Oxford: Clarendon Press.1962.

²² Në anglisht, *constitutive*.

²³ J. R. Searle, *Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*, Cambridge: Cambridge University Press, 1969, f. 34-35.

²⁴ Kent Bach and Robert M. Harnish, *Linguistic Communication and Speech Acts*, Cambridge, Mass.: MIT Press, 1979, kap. 3.

²⁵ Po aty, f. 47.

²⁶ Në anglisht, *acknowledgements*.

²⁷ Në anglisht, *constatives*.

Edhe pse në bazë kriteresh të ndryshme klasifikimi, klasa e udhëzueseve e Bahut dhe e Harnishit përkon në pjesën më të madhe me klasën e ushtrueseve të Ostinit dhe akoma më shumë me udhëzueset e Sërlit.

2.4. Metodologjia e Vunderlihit: një tjetër qasje ndaj aktit të të folurit

Vunderlihi (Dieter Wunderlich) ka bërë një përqasje më konstruktive ndaj teorisë së akteve të të folurit. Për të, akti i të folurit është një nga konceptet më të dobishme të teorisë gjuhësore bashkëkohore, pasi ka përqendruar vëmendjen drejt funksionit që ka gjuha në komunikimin njerëzor. Në këtë mënyrë teoria e akteve të të folurit lejon ndërthurjen e metodave dhe të fushave të ndryshme gjuhësore, siç janë teoria gramatikore, teoria e kuptimit dhe teoria e bisedës.

Duke e parë aktin e të folurit si pjesë e një njësie më të madhe, siç është biseda, analiza e tij duhet të jetë pjesë e analizës së përgjithshme të bisedës. Sipas Vunderlihit, konceptet më të rëndësishme që na ndihmojnë të analizojmë aktet e të folurit janë: radha, drejtimi i bisedës, aktet e pritshme të të folurit, njësia e përbërë e ligjërit, lloji i bashkëbisedimit dhe origjina e aktit²⁸.

Në bazë të rëndësisë që paraqesin këto elemente Vunderlihi përcakton 4 kriterë të ndryshme për klasifikimin e akteve të të folurit²⁹:

Së pari, aktet e të folurit mund të klasifikohen sipas shenjuesve kryesorë gramatikorë dhe gjegjëseve funksionale në një gjuhë të caktuar. Në anglisht këta shenjues janë llojet kryesore të fjalive³⁰. Kështu, fjalia pyetëse përdoret për akte të të pyeturit³¹; fjalia urdhërore për akte udhëzuese; fjalia dëftore për akte paraqitëse³² dhe gjithashtu, forma e performatives për akte deklaruese.

Së dyti, klasifikimi duhet të bëhet sipas përmbajtjes propozicionale dhe sipas kushteve të përmbushjes së aktit (analiza e Sërlit).

Së treti, duke e vendosur studimin e akteve të të folurit në lëmë të pragmatikës, Vunderlihi risjell në vëmendje funksionin dhe kontekstin e performimit të aktit të të folurit si përcaktues të kuptimit (të fjalëpërfjalshëm ose jo) të një fjalie, aktet e të folurit mund të klasifikohen në bazë të rolit që luajnë në ligjërim (si sekuenca të fillimit, të mbarimit etj.).

Së katërti, aktet e të folurit mund të klasifikohen duke marrë parasysh origjinën e tyre; si akte parësore apo natyrore dhe si akte dytësore apo institucionale. Sipas Vunderlihit, përparësia e njërit apo tjetrit kriter për

²⁸ D. Wunderlich, "Methodological remarks on speech act theory". In: J. Searle, F. Kiefer and M. Bierwisch (eds.). *Speech Act Theory and Pragmatics*. Dordrecht: D. Reidel Publishing, 1980, f.293-294.

²⁹ Po aty, f. 297-298.

³⁰ Në anglisht, *main grammatical moods*.

³¹ Në anglisht, *erotetic type*.

³² Në anglisht, *representative type*.

klasifikimin e akteve të të folurit do të varej nga përparësia e teorisë, në fushë të së cilës do të shtrihet studimi³³.

Në bazë të këtyre kriterëve, Vunderlihi përcakton edhe disa kufij të tjerë midis llojeve të akteve të të folurit. Në dallim nga Sërli, ai sheh nevojën për të trajtuar jashtë klasës së udhëzuesëve disa grupe aktesh. Sipas tij:

a) Pyetjet mund të formojnë një klasë të madhe të akteve të të folurit, pasi janë të dallueshme nga pikëpamja gramatikore. Nga ana tjetër, përfshirja e tyre brenda klasës së udhëzuesëve merr parasysh vetëm pyetjet e kufizuara dhe nuk lë mundësi për përfshirjen e pyetjeve të qëllimshme³⁴, pyetjeve retorike³⁵ etj.

b) Në klasifikimin e Sërlit nuk ka vend për akte të tilla si, paralajmërimet, këshillat, propozimet, ofertat, të cilat shfaqin tipare si të paraqitëseve, ashtu edhe të udhëzuesëve (apo të zotuesëve)³⁶.

c) Aktet thirrëse³⁷, pra akte nëpërmjet të cilave i drejtohem dikujt apo duam të tërheqim vëmendjen e dëgjuesit mund të përfaqësojnë për nga natyra e veçantë e tyre, sidomos për vendin që zënë në bisedë, një klasë më vete të akteve të të folurit.

3. Mjetet treguese të forcës ilokutive të udhëzuesëve në gjuhën shqipe

Një fjali, e cila shpreh në mënyrë të fjalëpërfjalshme³⁸ qëllimin e folësit, pra, që ka një kuptim të drejtpërdrejtë, mbart gjithmonë një forcë ilokutive të drejtpërdrejtë dhe përbën një akt të drejtpërdrejtë të të folurit. Studime të shumta në gjuhë të ndryshme tashmë, i njohin funksionin tregues të forcës ilokutive të një thënieje disa elementeve gjuhësore si, mënyra e foljeve, pikësimi, rendi i fjalëve në fjali, llojet e fjalive, vija intonacionore dhe theksi, foljet dhe formula performative etj.

Në gjuhën shqipe forca ilokutive udhëzuese gjendet e shprehur gjuhësisht:

- Në përdorimin e një performativeje eksplicite të emërtuar nga folja performative e pjesës kryesore, *p.sh., Të urdhëroj të largohesh.; Të premtoj se nesër....; Të uroj shërim të shpejtë!;* etj.

- Në përdorimin e njërës prej pesë llojeve të fjalive në shqipe për ato raste (për aq sa) kur këto lidhen në mënyrë respektive me forcën që i shoqëron tradicionalisht (fjalitë dëftore me forcën ilokutive të paraqitëseve; pyetëset, dëshiroret, dhe nxitëset me forcën ilokutive të udhëzuesëve; thirrmoret (por, në disa raste edhe dëshiroret) me forcën ilokutive të akteve shprehëse).

³³ Po aty, f. 297.

³⁴ Në anglisht, *deliberative questions*.

³⁵ Në anglisht, *retorical questions*.

³⁶ D. Wunderlich, *Assertions, conditional speech acts and practical inferences*, In: *Journal of Pragmatics*, vol.1, no.1, 1977, f. 13-46.

³⁷ Në anglisht, *vocative acts*.

³⁸ Në anglisht, *literal*.

- Në përdorimin e foljeve sipas formave mënyrore tipike për llojet respektive të akteve të të folurit (edhe pse shpesh, këto forma këmbehen njëra me tjetrën). Kështu, në gjuhën shqipe performohen akte paraqitëse kryesisht nëpërmjet shqiptimit të fjalive ku folja është në mënyrën dëftore, akte udhëzuese kur folja është në mënyrën urdhërore (por edhe dëshirore dhe lidhore), akte shprehëse kur folja është në mënyrën habitore etj.

- Në intonacionin e thënies (e shprehur në shkrim përmes pikësimit), por edhe në theksin logjik dhe në theksin emocionues të thënies.

3.1. Forma e performatives

Fjalitë performative janë një grup i veçantë i akteve të të folurit, që dallohen për

përdorimin e një foljeje performative në vetën I, koha e tashme, mënyra dëftore me një fjali të thjeshtë të përshtatshme plotësuese (në funksionin e plotësit). Shqiptimi i një fjalie performative është performimi i aktit ilokutiv të emërtuar prej foljes performative.

Sipas Sërlit³⁹ performativet kanë tri tipare dalluese:

- janë performim i akteve të përcaktuara dhe të emërtuara prej foljes performative;

- janë të vetëgarantuara⁴⁰ pra, performimi i tyre garanton qëllimin e folësit;

- dy tiparet e mësipërme arrihen përmes kuptimit të tyre të drejtpërdrejtë⁴¹, pasi karakteri performativ ose deklarues i këtij lloji të akteve të të folurit është parësor (del nga kuptimi i fjalëpërfjalshëm), ndërsa fakti që ato shprehin një pohim është dytësor.

Sipas Bahut dhe Harnishit⁴², një fjali performative në kuptimin e saj të fjalëpërfjalshëm është një pohim dhe në përdorime të tjera jo të drejtpërdrejta mund të përbëjë një akt të caktuar të emërtuar nga folja (premtoj, urdhëroj, deklaroj etj.). Pra, formula performative (forma e performatives) nuk është gjë tjetër veçse një nga mënyrat e shumta të përdorimit të fjalëve, të cilat janë standardizuar për përdorim jo të drejtpërdrejtë, që do të thotë se fjalitë performative përdoren për të performuar akte të tërthorta të të folurit.

Pavarësisht, nëse janë akte paraqitëse apo deklaruese, ajo që vihet re është njohja e performativeve (formës së performatives) si akte ilokutive me tipare dalluese, analiza e të cilave do të ndihmonte në përcaktimin e llojit të aktit ilokutiv të performuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo).

³⁹ J. R. Searle (1989), "How performatives work", *Linguistics and Philosophy* 12: 535-558.

⁴⁰ Në anglisht, *self-guaranteeing*.

⁴¹ Në anglisht, *literal*.

⁴² K. Bach and R. M. Harnish (1992) "How performatives really work", *Linguistics and Philosophy* 15: 93-110.

Siç u pa më lart, forma më e njohur e performatives në gjuhët e studiuar lidhet me përdorimin e një foljeje performative në vetën I, njëjës, koha e tashme, mënyra dëftore, forma veprorë me një fjali të thjeshtë të përshtatshme plotësuese (në funksionin e plotësit). Në fakt, qysh në fillimet e analizës së këtij objekti, Ostini i njeh statusin e performatives edhe disa formave të tjera thëniesh siç janë p.sh., përdorimi i një foljeje performative në vetën e dytë dhe e tretë dhe në joveprorë⁴³.

Duke marrë parasysh edhe këtë konstatim të hershëm, vihet re se edhe forma e performatives në gjuhën shqipe shpesh i kapërcehen kufijtë e përcaktimit të vetës, numrit dhe formës, duke bërë që thëniet performative të dalin edhe me folje ilokutive në forma të tjera, p.sh.⁴⁴:

- në vetën e parë, njëjës, e tashme, dëftore, joveprorë, p.sh., **Të falem** të më dëgjosh. **Të përgjërohem** për faljen tënde. **Të lutem** të më falësh. etj.
- në vetën e parë, shumës, e tashme, dëftore veprorë, p.sh., **Kërkojmë** të mbani qetësi. **Ju ftojme** të na nderoni me pjesëmarrjen tuaj. **Drejtujmë** vëmendjen në çështjen në fjalë. **Propozojmë** largimin nga detyra të...etj.
- në vetën e parë, shumës, e tashme, dëftore, joveprorë, p.sh., **Lutemi** për kontributin tuaj. **Angazhohemi** në projektin
- në vetën e dytë, numri njëjës ose shumës e tashme joveprorë, p.sh., **Ngarkohesh** me përgjegjësinë e postit. **Akuzohesh** për mashtrim. **Luteni** (jeni të lutur) të paraqiteni.... etj.
- në vetën e tretë, numri njëjës ose shumës e tashme veprorë dhe joveprorë, p.sh., **Kërkesa** juaj **aprovohet**. Me këtë nismë **stimulon** talentet e reja. **Autorizohen** organet zyrtare ... Sipas dekretit..., **falen** të burgosurit me dënime nga ... **Rekomandohet** mjekim i veçantë.
- pavarore p.sh., Nuk **lejohet** duhani. (**Ndalohet** duhani.) **Këshillohet** përdorimi i mjeteve mbrojtëse. **Lypset** punë e madhe. **Kërkohet** punëtor.
- njëvetore, Kontrata **i detyron** të dy palët. **Shtrohet** pyetja... etj.

Lidhur ngushtë me njohjen e performativeve, përgjithësisht pranohet ekzistenca e një grupi foljesh të quajtura *folje performative* ose *ilokutive*, tek të cilat qëllimi i folësit është pjesë përbërëse e kuptimit dhe përdorimi i të cilave në formën e performatives do të përbënte një kusht të vetëmjaftueshëm për të performuar atë akt që emërton vetë folja performative. Gjatë vjeljes dhe analizës së foljeve ilokutive është bërë një grupim sipas forcës ilokutive që këto folje mbartin në kuptimin (kuptimet) e tyre leksikore dhe që i shprehin në përdorimet e tyre. Edhe pse shpesh rezulton i vështirë, ky klasifikim paraqet një sprovë interesante në fushë të studimeve pragmalinguistike të shqipes, i

⁴³ Në anglisht, *impersonal passive*.

⁴⁴ Shembujt e përzgjedhur janë akte performative me forcë ilokutive udhëzuese (sipas Sërlit).

cili mund të ndiqet dhe plotësohet më tej, në mënyrë që të dalin në pah veçoritë që shfaq në këtë drejtim gjuha shqipe.

Për analizën e mëtejshme të foljeve ilokutive dhe përdorimit të tyre ilokutiv janë dalluar paraprakisht disa grupe foljesh ilokutive, përdorimi i të cilave në formën e një performativeje do të përbënte një akt të drejtpërdrejtë udhëzues:

- Folje të cilat në gjuhën shqipe dalin si ilokutive në të gjitha kuptimet dhe përdorimet e tyre, pra karakteri i tyre është mirëfilli ilokutiv. Të tilla folje udhëzuese në shqipe janë: *anuloj, betoj, ftoj, inkurajoj, këmbëngul, këshilloj, ngulmoj, lejoj, lejohej, lut, lutem, lyp, mëtoj, përbej, përbetoj, përgjëroj, përgjërohem, porosit, pretendoj, propozoj, pyes, sugjeroj, udhëzoj, urdhëroj* etj.

- Folje të cilat dalin si ilokutive në një ose disa kuptime (përdorime), pra janë pjesërisht të leksikalizuara: *detyroj 1,2, drejtoj 2,3, fal 1,2, falem 1, kërkoj 2,4, ndaloj 3, ngarkoj 5, orientoj 3, paralajmëroj 1, qortoj 1, rekomandoj 1,2, rrëzoj 5, sinjalizoj 2, thërres 3,4* etj.

- Folje të cilat përdoren si ilokutive vetëm në kontekste të caktuara dhe ilokutiviteti i të cilave nuk është leksikalizuar plotësisht: *aprovaj (kërkesën, lidhjen, ndërhyrjen etj.), bëj 9 (lutje, kërkesë, pyetje, thirrje etj.), dëshiroj (vëmendjen, mirëkuptimin etj.), dua 2 (fjalën, lejen, miratimin etj.), guxoj (të gre dyshimet, të dal kundër etj.), hedh 5 (me kuptimin drejtoj), hedh 12 (fajin, përgjegjësinë etj.), jap 4 (urdhër, komandën, pëlqimin, lejen etj.), kthej 14 (vëmendjen), lë 4 (trashëgim, këshillë, porosi, detyrë etj.), lë 8 (me kuptimin lejoj ose nuk e pengoj), liroj 6 (me kuptimin lejoj), marr 16 (marr guximin), ngarkoj 2 (i caktoj një detyrë etj.), pranoj 1 (kërkesën, lutjen etj.), sinjalizoj 2 (me kuptimin paralajmëroj), shtyj 2 (me kuptimin nxit), vë 22 (shpresat, faj, dyshim, diskutim etj.) etj.*

3.2. Llojet e fjalive dhe mënyra e foljeve

Në përvojën e studimeve gjuhësore është vënë re se thelbi i klasifikimit të akteve ilokutive në kuadër të teorisë së akteve të folurit është gjithashtu edhe thelbi i klasifikimit të fjalive sipas llojit të kumtimit në gramatikën tradicionale. Në këtë drejtim gjuhët indoevropiane shfaqin një prej ngjashmërive të shumta, duke dalluar në përgjithësi tri grupe të mëdha të fjalive⁴⁵: *deklarativet* (declarative), *pyetëset* (interrogative) dhe *urdhëroret* (imperative).

Sipas Sërlit, mënyra e foljes është një nga mjetet, që përcaktojnë forcën ilokutive të një thënieje, ndërsa në një punim tjetër, ai dhe Vandervekeni⁴⁶

⁴⁵ Në anglisht, *sentential mood*.

⁴⁶Searle & Vanderveken, *Foundations of illocutionary logic*, Cambridge: Cambridge University Press, 1985, f. 2-3.

theksojnë se mënyra së bashku me kontekstin luajnë rol vendimtar në përcaktimin e forcës ilokutive. Bahu dhe Harnishi⁴⁷ e

konsiderojnë mënyrën e foljes si shprehje të sjelljes ndaj vërtetësisë së fakti të shprehur, ndërsa më tutje, Harnish⁴⁸ e trajton atë si një fakt *sui generis*, si një mjet, që përcakton në mënyrë të drejtpërdrejtë forcën ilokutive potenciale të një fjalie. Sipas Vunderlihit⁴⁹ llojet e fjalive do të përbënin një ndër katër kriteret e tij për klasifikimin e akteve të folurit.

Duke pasur parasysh klasifikimin e Sërlit⁵⁰, mund të shtrihen disa paralele midis llojeve të fjalive dhe llojeve të akteve të folurit me qëllim analizën e mënyrës së foljes si një kriter i rëndësishëm për klasifikimin e llojeve të fjalive dhe njëkohësisht si një prej mjeteve që ndihmojnë në përcaktimin e forcës ilokutive të thënieve në gjuhën shqipe.

➤ Fjalitë pyetëse

Janë fjalitë me anë të cilave folësi kërkon të mësojë diçka prej bashkëbiseduesit a bashkëbiseduesve, diçka që nuk e di a që s'e di në mënyrë të plotë, ose do që të sigurohet për vërtetësinë e një fakti që njeh⁵¹. Këto fjali përdoren për të performuar akte si, të drejtuarit e një pyetjeje, të kërkuarit e një informacioni të caktuar, paraqitjen e temës së një diskutimi etj., akte të cilat Sërlit i trajton si një nënloj brenda udhëzuesve. Është parë e udhës që nënloji i akteve që performohen me shqiptimin e fjalive pyetëse (edhe pse i nënrenditur në klasën e udhëzuesve) të dallohet me emërtimin e sugjeruar nga Vunderlihi, *akte të pyeturit*.

Mënyra e foljes nuk vlen si një nga kriteret e dallimit të fjalive pyetëse, pasi ky kriter zëvendësohet plotësisht nga intonacioni, pikësimi, fjalët pyetëse dhe rendi i fjalëve.

➤ Fjalitë urdhërore

Në traditën e shqipes njihen si fjalitë dëshirore e nxitëse; janë fjalitë që shprehin vullnetin e folësit në formë dëshire apo kërkesë për realizimin ose mosrealizimin e një veprimi a të një gjendjeje⁵². Edhe pse janë përfshirë në kornizat e një grupi të fjalive, dallimet e rëndësishme midis dy nënlojeve sugjerojnë analiza të veçuara pragmatike.

- Fjalitë nxitëse

⁴⁷ K. Bach & R. M. Harnish, *Linguistic Communication and Speech Acts*, Cambridge, 1979.

⁴⁸ R. Harnish, *Mood, Meaning and Speech Acts*, London, 1994.

⁴⁹ D. Wunderlich, "Methodological remarks on speech act theory". In: J. Searle, F. Kiefer and M. Bierwisch (eds.). *Speech Act Theory and Pragmatics*. Dordrecht: D. Reidel Publishing, 1980, f. 296.

⁵⁰ J. Searle, *Expression and meaning: Studies in the theory of speech acts*. Cambridge, England: Cambridge University, 1979, f. 12-20.

⁵¹ *Gramatika e gjuhës shqipe II*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2002: § 4.7.

⁵² Po aty, § 4.6.

Janë fjalitë që shprehin kërkesën e qartë të folësit për realizimin e mosrealizimin e diçkaje dhe që japin shfaqje të ndryshme të vullnetit të tij, që prej urdhrorit të prerë deri te propozimi, porosit, këshilla, lutja, pranimit etj., duke performuar në shqiptimin tyre akte të tilla si, urdhra, komandime, kërkesa, të bërit thirrje (apel), sugjerime, udhëzime, lutje, ftesa për të bërë diçka, të lypurit, përgjërime, lejime, këshilla etj., të cilat përfshihen në klasën e udhëzuesëve. Qëllimi ilokutiv i akteve të kësaj klase ka të bëjë me përpjekjen e folësit që ta bëjë dëgjuesin të bëjë (të mos bëjë) një veprim të caktuar. Në fjalitë nxitëse përdoret zakonisht mënyra urdhërore, por edhe lidhërore e tashme, sidomos kur është fjala për një veprim a gjendje të vetës së tretë njëjës a shumës ose të vetës së parë shumës; gjithashtu edhe e ardhmja e mënyrës dëftore, veta e dytë njëjës e shumës; po ashtu edhe e tashmja e kësaj mënyre, veta e parë shumës⁵³:

Mu përgjigj! Afrohuni pa frikë. Merre në telefon sa më shpejt. Mos dil para të madhit. Le të shkojmë tani. Grupi i parë të drejtojë pyetjen e radhës. Të kthehem në temë. Nesër në mëngjes do të paraqitesh te drejtori. Do të shkosh aty ku shkojnë të gjithë. Çohemi. Fillojmë mbledhjen.

- Fjalitë dëshirore

Shprehin një fakt të dëshiruar prej folësit, diçka që folësi do që t'i ngjasë (ose të mos i ngjasë) atij, bashkëfolësit apo një tjetri. Këtu hyjnë urimet, mallkimet, sharjet, përshëndetjet, betimet etj. Qëllimi ilokutiv dhe gjendja psikologjike e shprehur që është dëshira e folësit bën të mundur që aktet e të folurit, që realizohen në shqiptimin e këtij grupi të fjalive të klasifikohen gjithashtu si udhëzuese. Kallëzuesi i fjalive dëshirore del zakonisht në mënyrën dëshirore, por edhe në mënyrën lidhore (lidhore-habitore) dhe në ndonjë rast edhe në kohë të ndryshme të dëftores⁵⁴:

Na u trashëgoftshin e na u shtofshin si zgjo i bletës. Të vafte mbarë. U shofte fara e armikut. Të qofte udha e mbarë e qofsh me nder. Sikur të kisha edhe unë njohjet e saj. Të bëhet një herë siç themi ne, pastaj shohim. Të kishte thënë një fjalë të paktën! Ta paskështa njohur më parë! Ah, që s'kishte edhe ai fuqinë e kreshnikëve!

Për shkak të karakterit të theksuar ekspresiv, nënloji i fjalive dëshirore mund të përqaset edhe me klasën e shprehësëve, por fakti që na bind për karakterin udhëzues të tyre është drejtimi i përshtatjes si një prej kriterëve, që Sërli ka vendosur në bazë të taksonomisë së tij, i cili përputhet me drejtimin e përshtatjes së klasës së udhëzuesëve.⁵⁵

⁵³ Po aty, § 4.6.2.1.2.–4.6.2.1.4.

⁵⁴ Po aty, § 4.6.1.

⁵⁵ Drejtimi i përshtatjes së udhëzuesëve është që bota t'i përshtatet fjalës, ndërsa ky kriter është mungesor tek shprehëset, pasi e vërteta e propozicionit të shprehur te këto akte është e parakuptuar.

Udhëzueset në gjuhën shqipe

Në mënyrë të përmblëdhur:

Akti ilokutiv	Qëllimi ilokutiv	Lloji i fjalisë	Mënyra e foljes (sipas shkallës së përdorimit)
Udhëzues	Folësi përpiqet të bëjë që dëgjuesi të kryejë (të mos kryejë) një veprim.	-Fjali nxitëse -Fjali dëshirore -Fjali pyetëse	-urdhërore -dëshirore -lidhore (e tashme, v. I,III) -dëftore (e ardhme, v.II) -----
Pyetës			

3.3. Intonacioni i udhëzueseve

Intonacioni përfshin gjithë ato dukuri që mbeten po të heqim nga mjetet prozodike të gjuhës tonet dhe llojet e ndryshme të theksave. Pra, dukuritë prozodike që veprojnë në nivelin e frazës dhe pikërisht: 1) ndryshimet e lartësisë së tonit themelor gjatë nyjetimit të frazës; 2) ndryshimet e shpejtësisë (tempit) së ligjëritimit; 3) ndryshimet e cilësisë së zërit (timbrit); 4) pauzat e gjatësive të ndryshme dhe 5) shenjat kufitare. Intonacioni kryen disa funksione gjuhësore, ndër të cilët më kryesoret janë: funksioni formësues i thënies, funksioni dallues, funksioni i aktualizimit të thënies dhe funksioni shprehës.⁵⁶ Këto funksione lidhen në tërësi me realizimin e një thënieje dhe me shprehjen e qëllimit të saj si një lloj akti ilokutiv. Kështu, funksioni formësues apo aftësia për ta shndërruar një fjalë a grup fjalësh në frazë (thënie) ndihmon në vendosjen e disa kufijve midis akteve ilokutive të performuar gjatë rrjedhës së ligjëritimit. Ky funksion ilustron në shembullin e sjellë nga prof. Memushaj për kompleksin tingullor apo njësinë leksikore *zjarr*, e cila e shqiptuar me një intonacion të caktuar, mund të kthehet në një thënie, kuptimi i së cilës varet nga lloji i lakores melodike me të cilën shoqërohet⁵⁷. Funksioni shprehës, emocionor shërben si mjet për të përcjellë qëndrimet dhe ndjenjat e folësit ndaj asaj që kumton ose ndaj dëgjuesit, ndaj, mund të marrë një rol përcaktues për llojet e akteve ilokutive shprehëse⁵⁸.

Në vijim edhe të asaj që u parashtrua në çështjen paraardhëse, intonacioni vlen si një nga mjetet për të dalluar llojet kryesore të thënieve. Ky funksion bëhet i mundur në sajë të lëvizjes së lakores melodike, e cila mund të jetë *ngjithëse* ose *zbritëse*. Lëvizja *zbritëse* ose intonacioni *zbritës* tregon karakterin e përfunduar të thënies dhe është karakteristike për fjalitë dëftore. Intonacioni *ngjithës* tregon karakterin e papërfunduar të thënies dhe karakterizon sintagmat dhe fjalitë pyetëse.

⁵⁶ R. Memushaj (2009), *Fonetika e shqipes standarde*, Botimet Toena, Tiranë, f. 170-171.

⁵⁷ Po aty, f. 171.

⁵⁸ Në anglisht, *expressives*.

Në paraqitjen dhe përshkrimin e lakoreve melodike të frazave në shqipe, prof. Memushaj ka veçuar ndër të tjera edhe disa lloje frazash, analiza e të cilave do të ishte e dobishme për të njohur disa nga veçoritë e intonacionit të thënieve që përdoren për të performuar akte të drejtpërdrejta udhëzuese në gjuhën shqipe.

Duke u nisur nga këto përshkrime, duhet vënë në dukje se aktet udhëzuese pyetëse dallohen nga llojet e tjera brenda grupit të udhëzueseve. Në pjesën më të madhe të frazave pyetëse: me dhe pa rend të përmbysur të kryefjalës dhe kallëzuesit; frazat pyetëse mohore dhe dyshuese; frazat pa fjalë pyetëse, por me rend të përmbysur intonacioni është ngjithës. Dallimi midis këtyre frazave paraqitet në nivelet e ngritjes së tonit. Kur intonacioni është mjeti i vetëm për të bërë dallimin mes pyetjes dhe jo pyetjes (rasti i frazave pa fjalë pyetëse dhe i frazave pa rend të përmbysur) toni ngrihet shumë dhe lakorja i afrohet nivelit maksimal të lartësisë. Kur intonacioni nuk është mjeti i vetëm (rastet e tjera) toni nuk ngrihet aq lart dhe si rrjedhim lakorja melodike është më e ulët. Intonacioni i pyetëseve shoqërohet në shkrim kryesisht nga pikëpyetja, por edhe nga pikëpyetja dhe pikëçuditja në rastet kur ato shprehin edhe një qëndrim afektiv.

Në disa grupe të tjera të frazave pyetëse si, te frazat me fjalë pyetëse, frazat pyetëse të zhdrejta dhe frazat pyetëse me pyetje alternative vihet re një lakore e ngjashme me lakoret e frazave dëftore. Dallimi në këto raste vihet re te ngritja në një nivel mjaft të lartë e tonit në fjalët pyetëse (për frazat me fjalë pyetëse) dhe gjithashtu, një ngritje e konsiderueshme te folja ose fjala pyetëse për frazat e tjera⁵⁹.

Frazat nxitëse, në dallim nga pyetëset kanë një lakore zbritëse, të ngjashme me lakoren e frazave dëftore, po në një nivel pak më të lartë. Lakoret e frazave nxitëse paraqiten deri diku ndryshe në varësi të kuptimeve modale që shprehin: nëse shprehin një urdhër kategorik, një urdhër të zbutur apo një urdhër në formë lutjeje⁶⁰. Frazat nxitëse kanë shpesh karakter të dukshëm afektiv duke marrë njëkohësisht edhe karakter thirrмор dhe ndaj në shqipe këto raste trajtohen si nxitëse-thirrmore. Në këto raste, ndryshe nga raste kur karakteri thirrмор nuk është edhe aq i dukshëm, ato shoqërohen me pikëçuditje. Karakteri thirrмор ose jo thirrмор mund të varet nga shkalla e nxitjes, situata në të cilën flet folësi dhe nga qëndrimi afektiv ndaj asaj që kumton⁶¹.

Për shkak të karakterit të theksuar emocionues, lakoret e intonacionit të frazave dëshirore nuk paraqitin rregullsinë e frazave dëftore, pyetëse dhe

⁵⁹ Po aty, f. 176.

⁶⁰ Po aty, f. 178.

⁶¹ *Gramatika e gjuhës shqipe II* (2002). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, f.133.

⁶² R. Memushaj (2009), *Fonetika e shqipes standarde*, Botimet Toena, Tiranë, f. 179-180.

nxitëse dhe ngjajnë me lakoret e frazave thirrmore. Ato janë të çrregullta dhe përgjithësisht me një ngritje të tonit të fjala që shpreh ngjyrimin afektiv. Pas këtyre fjalëve toni mund të ulet ose mund të vijojë, gjë që varet nga prania ose mungesa e pauzës deri te fjala ndjekëse⁶². Duke qenë se ato shprehin një fakt të dëshiruar prej folësit, fjalitë dëshirore dalin (edhe më shpesh se nxitëset dhe pyetëset) si dëshirore-thirrmore dhe në këto raste shoqërohen në shkrim nga pikëçuditja.

BIBLIOGRAFI

- D. Wunderlich (1977), *Assertions, conditional speech acts and practical inferences*, Journal of Pragmatics, vol. 1, no. 1, f. 13-46.
- D. Wunderlich (1980), "Methodological remarks on speech act theory". In: J. Searle, F. Kiefer and M. Bierwisch (eds.), *Speech Act Theory and Pragmatics*. Dordrecht: D. Reidel Publishing. Pp. 291-312.
- F. Recanati (1987), *Meaning and Force: The Pragmatics of Performative Utterances*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Fjalor i shqipes së sotme*, (2002). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimet Toena, Tiranë.
- Gramatika e gjuhës shqipe I* (2002). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
- Gramatika e gjuhës shqipe II* (2002). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
- J. L. Austin (1962), *How to do things with words*, Oxford University Press, Oxford.
- J. R. Searle (1969), *Speech Acts: An Essay in the Philosophy of Language*, Cambridge: Cambridge University Press.
- J. R. Searle (1979), *Expression and meaning: Studies in the theory of speech acts*, Cambridge: Cambridge University.
- J. R. Searle (1989), *How performatives work*, Linguistics and Philosophy 12: 535-558.
- J. R. Searle (2002), *Consciousness and language*, Cambridge: Cambridge University Press.
- J. R. Searle, D. Vanderveken (1985), *Foundations of illocutionary logic*, Cambridge: Cambridge University Press.
- J. Verschueren (1980), *On speech act verbs*, Amsterdam: John Benjamins.
- J. Verschueren (1985), *What people say they do with words: prolegomena to an empirical-conceptual approach to linguistic action*, Norwood, NJ: ALEX.
- K. Bach & R. M. Harnish (1992), *How performatives really work*, Linguistics and Philosophy 15: 93-110.
- K. Bach and R. M. Harnish (1979), *Linguistic Communication and Speech Acts*, Cambridge, Mass.: MIT Press, Cambridge: ch. 10.
- P. Grice (1989), *Studies in the Way of Words*, Cambridge, MA: Harvard University Press.
- R. Harnish (1994), *Mood, Meaning and Speech Acts*, in S. Tsohatzidis (ed.), *Foundations of Speech Act Theory: Philosophical and Linguistic Perspectives*, Routledge, London, pp. 407-459.
- R. Memushaj (2009), *Fonetika e shqipes standarde*, Botimet Toena, Tiranë.

- S.C. Levinson (1983), *Pragmatics*, Cambridge: Cambridge University Press.
Sh. Rrokaj (2000), *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, SHBLU, Tiranë.
Sh. Rrokaj (2010), *Filozofi e gjuhës*, Arbëria, Tiranë.
Sh. Rrokaj, G. Belluscio (2011), *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë.
Xh. Lloshi (2001), *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, SHBLU, Tiranë.